

## PROCESVERBAL

**Dëgjesa Publike për Projektbuxhetin Afatmesëm 2026–2028 dhe Buxhetin Vjetor 2026 në Njësinë Administrative Leshnje**

**Datë:10.11.2025**

**Vendi:Ambientet e Njesisë Administrative Leshnjë**

Të pranishëm:

- Z. Arben Hodo – Administrator i Njesisë Leshnje
- Znj. Sonila Hysenbelliu – Nënkryetare e Bashkisë
- Z.Naim Gogo - Drejtori i Financës të Bashkisë
- Z. Edmond Omeri – Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike
- Banorë të zonave përkatëse
- Anëtarë të Këshillit të Bashkisë

### **Hapja e dëgjësës**

Dëgjesa u hap nga Administratori i Njesisë Administrative Leshnjë, z. Arben Hodo, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe theksoi rëndësinë e konsultimit publik për hartimin e projektbuxhetit afatmesëm dhe buxhetit vjetor të vitit 2026.

Më pas mori fjalën Nënkryetarja e Bashkisë, znj. Sonila Hysenbelliu, e cila falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, pavarësisht kushteve të vështira atmosferike dhe reshjeve të shumta. Ajo vuri në dukje rëndësinë e angazhimit të komunitetit në procesin e konsultimit publik dhe theksoi se bashkia vlerëson çdo mendim dhe sugjerim të banorëve, pasi ato ndihmojnë në hartimin e një buxheti më të drejtë dhe më të përshtatur me nevojat reale të zonës.

Më pas fjalën e mori Drejtori i Financës, z. Neim Gogo, i cili prezantoi:

- Projektbuxhetin Afatmesëm 2026–2028,
- Buxhetin vjetor 2026,
- Programet dhe prioritetet kryesore të parashikuara për investime,
- Ndërhyrjet e planifikuara në çdo njësi administrative të Bashkisë.

Ai dha një përmbledhje të përgjithshme të politikave buxhetore dhe synimeve të planit afatmesëm, si dhe ftoi banorët të shprehnin mendimet dhe shqetësimet e tyre.

### **Diskutimet dhe shqetësimet e banorëve**

Z. **Belul Çela** – Banor i fshatit Gostencë parashitroi disa çështje dhe kërkesa që lidhen me zonën e Gostencës:

1. Informacion mbi investimet e përfshira në projekt-buxhet për zonën e tyre.
2. Përqindjen e investimeve të realizuara nga bashkia në këtë zonë.
3. Shërbimet e ofruara deri më tani për komunitetin.
4. Prioritetet dhe planifikimet që janë bërë për periudhën 2026–2028.
5. Mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve, e kanalizimeve, si dhe shërbimeve të rregullta të pastrimit.
6. Vuri në dukje se në zonë operojnë biznese minerare dhe hidrocentrale, por komuniteti nuk përfiton nga aktiviteti i tyre. Ai propozoi që bashkia të bashkëpunojë me këto subjekte për të siguruar mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore dhe përmirësimin e kushteve.
7. Kërkoj mbështetje konkrete për bujqësinë, duke theksuar se fermerët kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme.
8. Shprehu shqetësim për nivelin e ulët të pagesës së kryepleqve, duke kërkuar që në buxhet të parashikohet rritja e shpërblimit në raport me përgjegjësitë që mbajnë.

**Z. Adil Kumbara** – Banor i fshatit Leshnjë ngriti shqetësimin mbi:

- Çmimin e ujit të pijshëm,
- Nevojën për një verifikim të saktë të numrit real të banorëve në të gjitha familjet,

Ai sqaroi se aktualisht fshati paguan tarifën e ujit për frymë, edhe për persona që nuk banojnë më në atë adresë. Në rastin e tij, megjithëse familja përbëhet nga 2 persona, ai detyrohet të paguajë për 7 persona, duke paguar në mënyrë të paafëtësuar për anëtarë të familjes që janë larguar.

Ai kërkoj rishikim të menjëhershëm të kësaj praktike dhe përafrim të pagesave me numrin real të banorëve rezidentë.

### **Mbyllja e dëgjësës**

Nënkryetarja znj. Sonila Hysenbelliu theksoi se të gjitha sugjerimet dhe shqetësimet e ngritura do të merren në konsideratë gjatë finalizimit të buxhetit të vitit 2026 dhe planifikimit afatmesëm 2026–2028.

**Sekretare Këshillit**

**Xheni Çela**








REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

Datë 10.11.2025

Lista e pjesëmarrësve në konsultimin public, me objektin "Për Miratimin E Projekt - Buxheti Afatmesëm 2026-2028 Të Bashkisë Skrapar Dhe Institucioneve Në Varësi Të Saj"

Njësia Administrative Leshnje

Nr	Emër/Mbiemër	Fshati	Nr.tel	Nëshkrimi
1	Arben Hodo	Leshnje	0683701807	
2	Belul Sola	Gostemcë	0683068276	
3	Abos Mita	Gostemcë	0684610423	
4	Adil Kumbura	Leshnje		
5	Gjergji Hodo	Tru bukovë	0688400511	
6	Valona Gropa	Leshnje	0688444083	
7	Adil Kumbura	Leshnje	0684870423	
8	Skendilajt Jaupllari Enver Qabaj	Keshilli Bashkia	0686150666	
9		Keshilla	0672905958	
10	Pëllumb	GUTI	068671295	
11	Yonila Gjysenelli	B. Skrapar	0682550716	

12					
13	Na'im Gogo	B. Skrapar	06P756443P		
14	Edmond Emfiri	N.SP. Pucube	06P.40.38.660		
15	Xheni Gelo	Sek. Keshillit	0675405816		
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					